Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 37/17
Date/Datum. 07.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	**06.03.2017**
REFERENCË:	**37/17**
PËR/ZA/TO:	**AK – Komuna Ferizaj** **OE ankues Art Trade - Ferizaj**
CC:	
NËPËRMJET/PREKO/THROUGH	**Arkiva OSHP**
NGA/OD/FROM:	**Kryetari i panelit shqyrtues z.Goran MILENKOVIC**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori Ekonomik **"Art Trade" – Ferizaj**, si palë e pa kënaqur me datën: 06.02.2017, ka parashtruar ankesë me Nr. 37/17, në Organin Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për kontratë të datës 30.01.2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1"** dhe **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II"**, me numër të prokurimit: 656/17/352/322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Ferizaj,** duke pretenduar se AK-ja, nuk e ka respektuar nenin 46 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113.1 të LPP-së, me datë: 22.02.2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues z. Visar Basha, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të OE "Art Trade" – Ferizaj.

Eksperti shqyrtues me datën: 01.03.2017, ka dorëzuar raportin e ekspertizës, me gjithë sqarimet dhe rekomandimin e tij, në lidhje me ankesën e lartpërmendur, me ç'rast ka konstatuar se pretendimet e OE ankues janë të qëndrueshme dhe se këtij aktiviteti të prokurimit duhet ti zgjatet afati për pranimin e ofertave, për shkak se AK-Komuna e Ferizajit nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 46 të LPP-së.

Me datën: 01.03.2017, Autoriteti Kontraktues Komuna Ferizaj, si dhe OE ankues "Art Trade" – Ferizaj, e kanë pranuar raportin e ekspertit shqyrtues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1" dhe "Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II", me numër të prokurimit: 656/17/352/322.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet** me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues në raportin e datës: 01.03.2017.

Operatori ekonomik, poashtu përmes parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet** me mendimin e dhenë të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, njofton Autoritetin Kontraktues – Komunën e Ferizajit, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues - Komuna e Ferizajit, urdhërohet që të veproj konform rekomandimeve të dhëna në raportin e ekspertizës së datës 01.03.2017, për aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1" dhe "Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II", me numër të prokurimit: 656/17/352/322, konform dispozitave të LPP-së Nr. 04/L-042.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues zbatimin e këtij urëdhëri, dhe në afat prej 15 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues "Art Trade" – Ferizaj, konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.